

V E N D I M
Nr.6, datë 9.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““

Me sekretare Drita Filto, më datë 19.10.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.52/3 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: VEHBİ ALIMUÇAJ, e përfaqësuar nga avokatët Liljana Korvafaj, Abaz Brati e Florian Kolaneci.

O B J E K T I:

Papajtueshmëria e vendimit datë 30.4.1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; vendimeve nr.73, datë 1.6.1998 dhe nr.93, datë 13.7.1998 të Gjykatës së Kasacionit, me ligjin themelor.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shpalljen antikushtetuese të vendimeve të gjykatave:

1. Organet e prokurorisë nuk kishin të drejtë të fillonin ndjekjen penale dhe të kryenin veprimet procedurale përderisa me një ligj të veçantë është ndaluar kryerja e tyre ndaj qytetarëve të lidhur me personat juridikë jo bankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.

2. Gjykata e Kasacionit duhet të shqyrtonte rekursin e drejtpërdrejtë brenda 10 ditëve. Mosshqyrtimi i tij në afat dhe moslirimi i të pandehurit sipas nenit 249 pika 5 e 7 të Kodit të Procedurës Penale cënojnë lirinë e personit si dhe të drejtën e ankimit.

3. Pavarësisht se çështja u shqyrtua më parë në Dhomën e Këshillimit, Kolegji Penal duhet të dëgjonte mbrojtësit e të pandehurit drejtpërdrejt. Kjo përbën proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Të drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Prokuroria e rrethit Tiranë ka akuzuar kërkuesin Vehbi Alimuçaj në datën 28 prill 1998 për krimin e mashtrimit të qytetarëve sipas neneve 143 e 25 të Kodit Penal dhe Gjykata e Rrethit Tiranë me vendimin datë 30.4.1998 ka caktuar si masë sigurimi ndaj tij atë të arrestit në burg me afat 15 ditor.

Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Kasacionit kërkuesi dhe ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë prokurori. Ndërsa kërkuesi kërkoi ndryshimin e masës së sigurimit e lënien e tij të lirë, prokurori kërkoi që masa e arrestit të jetë pa afat.

Fillimisht çështja u shqyrtua në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.58, datë 13.5.1998 vendosi pranimin e kërkesës së prokurorit dhe caktimin si masë sigurimi ndaj kërkuesit Vehbi Alimuçaj atë të arrestit në burg pa afat. Mbi rekursin e këtij të fundit Kolegji Penal i Gjykatës së Kasacionit në Dhomën e Këshillimit në datë 1.6.1998, vendosi mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk janë shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, për të kaluar çështjen për gjykim. Meqenëse rekursi i drejtpërdrejtë ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë ende nuk ishte shqyrtuar, çështja u kalua në seancë gjyqësore dhe Kolegji Penal vendosi pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se është shqyrtuar më parë në Dhomën e Këshillimit.

Përsa sipër Gjykata Kushtetuese konkludon se nuk jemi para një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Si ankimi i prokurorit ashtu edhe rekursi e të pandehurit janë shqyrtuar nga gjykatat sipas përkatësisë dhe nuk del të ketë shkelje të karakterit kushtetues. Gjykata e Apelit dhe ajo e Kasacionit ishin njëkohësisht kompetente për shqyrtimin e çështjes.

Mosgjykimi i rekursit të drejtpërdrejtë brenda 10 ditëve nga Gjykata e Kasacionit siç parashikon pika 5 e nenit 249 të Kodit të Procedurës Penale nuk përbën cënim të lirisë vetiake, të parashikuar në nenin 5 të ligjit të mësipërm për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, sepse vonesa është e përligjur me shqyrtimin e kësaj çështje nga Gjykata e Apelit po brenda 10 ditëve. Vendimi i Gjykatës së Rrethit u shfuqizua nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Kasacionit nuk kishte çfarë të shqyrtonte më kur iu paraqit rekursi i drejtpërdrejtë. Veç kësaj edhe pse kaloi afati i shqyrtimit të rekursit të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Kasacionit, nuk mund të zbatohet neni 249 pika 7 e Kodit të Procedurës Penale, për lirimin e të pandehurit, sepse brenda afatit 10 ditor ishte marrë një vendim nga Gjykata e Apelit që ishte kompetente për shqyrtimin e çështjes dhe që kishte caktuar si masë sigurimi ndaj Vehbi Alimuçës, arrestin pa afat.

Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim pretendimin e kërkuarit sipas të cilit organet e prokurorisë nuk kishin të drejtë të fillonin procesin penal ndaj tij, përderisa kjo ishte ndaluar me nenin 3, paragrafi i dytë i Ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jo bankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”. Gjykata Kushtetuese konstatoi se neni 3 paragrafi i dytë i ligjit në fjalë ka patur më shumë karakterin e një urdhërimi administrativ se sa të një norme procedurale penale. Duke patur këtë natyrë, ajo ka qenë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese sepse ishte ndërhyrje e pushtetit legjislativ në atë gjyqësor, duke cënuar pavarësinë e këtij të fundit.

Mosfillimi i proceseve penale për aq kohë sa do të vazhdonte kontrolli i firmave piramidale i hiqnin mundësinë organeve të prokurorisë të zbatonin detyrat kushtetuese të mbrojtjes së interesave të përgjithshme të shoqërisë, të rendit juridik dhe të të drejtave të shtetasve dhe, për çështje konkrete, e bënë të ndërvarur pushtetin gjyqësor nga ai ekzekutiv. Duke qenë para një dispozite të tillë, prokuroria ka pranuar të respektojë detyrimet kushtetuese, duke mënjanuar urdhërimet e dispozitës në fjalë.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PARALEL

Gjykata e Kasacionit duhej sipas ligjit ta kishte shqyrtuar më parë rekursin e ankuesit të bërë kundër masës së sigurimit, pasi ajo ishte depozituar më datë 4.5.1998, ndërsa rekursi kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ishte bërë pas datës 13.5.1998. Por duke qenë se nuk e kishte shqyrtuar në afat dhe u njoftua për rezultatin e vendimit të Gjykatës së Apelit, rekursi i parë nuk kishte më se si të merrej parasysh edhe sepse Gjykata e Kasacionit ishte shprehur një herë me vendim sipas nenit 433 të Kodit të Procedurës Penale.

Përsa i përket pretendimit se Gjykata e Rrethit duhej të kishte zbatuar për ankimin nenin 3/2 të Ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 që ishte në fuqi në kohën e shqyrtimit të kërkesës kundër masës së arrestit, ai pretendim qëndron sepse ajo dispozitë nuk ishte tjetër veçse një rregull e një procedurë që duhej ndjekur nga prokuroria. Kjo, sipas Kushtetutës është me të vërtetë organi që ushtron ndjekjen

penale, por këtë nuk mund ta bëjë veçse duke u udhëhequr nga kriteret e ligjit procedural dhe në rastin konkret një rregull i tillë për mosmarrjen e masës së arrestit ishte edhe neni 3/2 i ligjit të lartpërmendur që e ndalonte ndjekjen. Këtu është e vërtetë kjo sepse sipas Kushtetutës prokuroria mbrohet edhe interesin e përgjithshëm edhe liritë dhe të drejtat e shtetasve. Nga ana tjetër antikushtetutshmërinë e ligjit mund ta deklarojë vetëm Gjykata Kushtetuese dhe Kuvendi.

Por duke qenë se ankimi në drejtimin e sipërm bëhet kur neni 3/2 i ligjit të lartpërmendur ishte shfuqizuar nga një ligj i mëvonshëm që ishte në fuqi kur është shprehur Gjykata e Apelit për masën e arrestit, nuk kishte sesi të merrej parasysh për t'u zbatuar.

A N Ë T A R I
Hilmi Dakli

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të dhënë me shumicë votash për këto arsye:

Gjykata pranon se paragrafi i tretë i nenit 3 të Ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jo bankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", nuk pajtohet me parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve, sepse lejon ndërhyrjen e legjislativit në veprimtarinë e pushtetit gjyqësor, duke i penguar organet e tij në ushtrimin e funksioneve të tyre. Megjithatë, ajo nuk duhet të dilte me vendim për rrëzimin e kërkesës, për shkak se të gjitha vendimet gjyqësore, objekt i kësaj kërkesë, nuk janë rezultat i një procesi të rregullt ligjor.

Parregullsia e këtij procesi ka të bëjë me faktin se në gjykimin e çështjes që kishte për objekt vlerësimin e masës së arrestit të zbatuar nga prokuroria kundër kërkuesit, gjykatat e zakonshme të të trija shkallëve nuk kanë pasur parasysh kërkesat e nenit 8 paragrafi i dytë i ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 "Për organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese".

Sipas kësaj dispozite, përderisa gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen, ashtu si edhe Gjykata Kushtetuese, kanë arritur në përfundim se paragrafi i tretë i nenit 3 të ligjit të sipërpërmendur, i cili urdhëronte mosfillimin e proceseve gjyqësore e hetimore pa përfunduar kontrolli financiar i veprimtarisë së personave juridikë që kishin marrë hua nga publiku i gjerë, ku bën pjesë edhe shoqëria tregtare e drejtuar nga kërkuesi, nuk pajtohet me Ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese", ata ishin të detyruar të pezullonin gjykimin dhe materialet e çështjes t'ia përcillnin kësaj Gjykate, me qëllim që kjo t'ia nënshtronte kontrollit të saj konstitucional këtë normë të këtij ligji të zakonshëm.

Mosrespektimi i kësaj procedure të sanksionuar në ligjin kushtetues, dmth., zgjidhja nga ana e tyre e çështjes në themel, pa u shprehur më parë Gjykata Kushtetuese për papajtueshmërinë e kësaj norme juridike me ligjin kushtetues, por duke vendosur ata vetë të mos e zbatojnë atë si të tillë, për mendimin tim përbën cënim të lirisë jo nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, pra shkelje të së drejtës kushtetuese të parashikuar nga neni 38 i Ligjit për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut".

Nga ana tjetër nuk më duket i drejtë edhe qëndrimi që mban shumica në vendimin e saj. Ajo ka arritur në konkluzion se prokuroria dhe gjykata kanë bërë mirë që në zgjidhjen e kësaj çështje kanë zbatuar Kushtetutën dhe nuk kanë zbatuar ligjin që nuk pajtohet me të, i cili ndalonte fillimin e procedimit penal kundër kërkuesit. Ky konkluzion vjen në kundërshtim me sistemin e kontrollit konstitucional të pranuar si në Ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" ashtu edhe në Kushtetutën e Re të Republikës së Shqipërisë.

Në të dy këto akte themelore është parashikuar përqëndrimi i këtij kontrolli në dorën e një organi të vetëm që është Gjykata Kushtetuese, pra ai nuk është i shpërndarë edhe midis organeve të tjera. Kjo do të thotë se këto të fundit nuk kanë të drejtë të mos zbatojnë një ligj të zakonshëm edhe kur çmojnë se ky është antikushtetues, por që është ende i pashfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

Prandaj, për arsyet e lartpërmendura, jam i mendimit për pranimin e kërkesës së ushtruar nga kërkuesi dhe për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara prej tij.

A N Ë T A R I
Z.Vuci

Tiranë, më 9.3.1999

Nr. 52/3 i regjistrit themeltar
Nr. 6 i vendimit.